VENDIM
Nr. 236, datë 22.9.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "BINDI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 170, DATË 26.10.2017

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 13, si dhe nenit 16, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/5 prot., datë 19.9.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'BINDI' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017",

konstatoi se:

- Shoqëria "Bindi" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 387, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 218, datë 1.9.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Bindi" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218/2022, i cili u publikua në datat 2.9.2022 dhe 3.9.2022. Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 16.9.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me shkresën nr. 1385/4 prot., datë 7.9.2022, ERE iu drejtua shoqërisë "Bindi" sh.p.k. me shkresën "Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni", ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1385/5 prot., datë 13.9.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Shoqëria "Bindi" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.
- Shoqëria "Bindi" sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 387, seria T17, të shoqërisë "Bindi" sh.p..k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që

mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti